



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, e konform nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 20.05.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI-për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

- 1.1 Banesa**, e cila gjendet në rrugën “**Brigada 123**” në Suharekë, **Blloku “C”** shifra 19, **Nr. 23**, sipas sistemit të unifikuar të adresave, **kati VI**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=64.66m²**, pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.
- 1.2 Banesa**, e cila gjendet në rrugën “**Brigada 123**” në Suharekë, **Blloku “B2”** shifra 12, **Nr. 26**, sipas sistemit të unifikuar të adresave, **kati VI**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=61.70m²**, pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.
- 1.3 Banesa**, e cila gjendet në rrugën “**Brigada 123**” në Suharekë, **Blloku “B2”** shifra 12, **Nr. 31**, sipas sistemit të unifikuar të adresave, **kati VII**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=61.70m²**, pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqytës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr- 016-18207
Më datë 21.05.2020



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI